

REKOMANDIMET KRYESORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ADRESIMIN E PROBLEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI

1. Bazat dhe autorizimi për ndalimin/paraburgimin

- Sqarimi i koncepteve të paqarta ligjore – zhvillimi i përkufizimeve të qarta ligjore ose udhëzimeve gjyqësore për terma të paqartë si “arsye të rëndësishme” ose “rrezik i veçantë” (nenet 228–230 të KPP).
- Përafrimi i terminologjisë me standardet ndërkombëtare dhe me Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/681, për të garantuar parashikueshmëri dhe siguri juridike.
- Vendosja e pragjeve të qarta të veprave penale për paraburgimin – shqyrtimi i ndryshimit të KPP për të futur një prag minimal të dënimit me burg për caktimin e paraburgimit (në këtë Guiding Paper propozohet pragu tre vjet, por jo më pak se një vit, sipas Rekomandimit të Komisionit (BE) 2023/681).
- Forcimi i kërkesave për arsyetim gjyqësor – zbatimi rigoroz i nenit 245 të KPP, duke kërkuar që gjyqtarët të japin arsyeime të individualizuara dhe specifike për rastin kur vendosin paraburgimin.
- Futja e mjeteve të strukturuar të vlerësimit të rrezikut, për të ndihmuar gjyqtarët të vlerësojnë nëse masat më pak kufizuese mund të adresojnë në mënyrë të mjaftueshme rreziqet.
- Detyrimi i gjykatave për të dokumentuar shprehimisht në vendim arsyet pse masa si garancia pasurore, detyrimi për paraqitje apo mbikëqyrja elektronike nuk janë të mjaftueshme.

2. Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore

- Përmirësimi i cilësisë së arsyetimit gjyqësor – ofrimi i trajnimeve dhe mekanizmave monitorues për të siguruar që vendimet për paraburgim përmbajnë arsyeime të detajuara dhe të individualizuara, jo referenca formale apo stereotipike; arsyetimi duhet të trajtojë shprehimisht pse alternativat janë të pamjaftueshme dhe pse paraburgimi është rreptësisht i domosdoshëm.
- Investimi në rritjen e kapaciteteve gjyqësore – zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët.

- Zgjatja e afatit për paraqitjen e ankimit kundër vendimeve për paraburgimin nga pesë në dhjetë ditë.
- Forcimi i mbikëqyrjes nga gjykatat e apelit – rritja e efektivitetit të mekanizmave të ankimit, duke siguruar që gjykatat e apelit të shqyrtojnë me rigorozitet arsyetimin e dhënë në shkallën e parë.
- Sqarimi i fushës së shqyrtimit në apel – ndryshimi i nenit 249 të KPP për të përcaktuar shprehimisht se gjykatat e apelit duhet të shqyrtojnë si elementet faktike ashtu edhe ato juridike të vendimit për paraburgim, përfshirë provat në dispozicion, bazat e invokuara (rreziku i ikjes, rreziku i përsëritjes së veprës, pengimi i drejtësisë), si dhe proporcionalitetin e paraburgimit në raport me alternativat.
- Garantimi i të drejtës për t'u dëgjuar në apel – sanksionimi në ligj i detyrimit që si i dyshuari ashtu edhe avokati i tij të dëgjohen gjatë procedurës së ankimit.

3. Kohëzgjatja dhe rishikimi periodik i paraburgimit

- Kufizimi i kohëzgjatjes maksimale – vendosja e afateve strikte maksimale, të cilat mund të tejkalohen vetëm në raste vërtet të jashtëzakonshme dhe vetëm mbi bazën e justifikimeve konkrete, të individualizuara dhe të arsyetuara mirë.
- Forcimi i standardeve të cilësisë së rishikimit – vendosja e kritereve më të forta për thellësinë, pavarësinë dhe arsyetimin e rishikimeve, për të garantuar që ato të jenë thelbësore dhe jo formale.
- Fokusimi i rishikimit periodik në vlerësimin nëse paraburgimi vazhdon të jetë i domosdoshëm, proporcional dhe i arsyeshëm, dhe jo vetëm në ecurinë e hetimit.
- Vendosja e parimit të përgjithshëm që prokurori duhet të kërkojë edhe prova në favor të personit nën hetim dhe ta informojë gjykatën në mënyrë të menjëhershme.
- Heqja e parashkrimit kohor prej 6 muajsh për kundërshtimin e kohëzgjatjes së paraburgimit (i vetmi kufizim duhet të jetë ndalimi i përsëritjes së argumenteve që janë paraqitur dhe shqyrtuar tashmë).

- Përcaktimi që afati kohor të fillojë të llogaritet nga momenti i masës së mëparshme të sigurimit edhe për vepra të ndryshme të kryera para lëshimit të urdhrit të parë, kur ekziston lidhje sipas nenit 55 të Kodit Penal.
- Vendosja e ekuivalencës midis arrestit në shtëpi dhe paraburgimit, duke ndryshuar mënyrën e zbritjes në dënimin përfundimtar, në mënyrë që një ditë paraburgim/arrest shtëpie të barazohet me një ditë dënim përfundimtar.

4. Aksesit në avokat dhe garanci të tjera procedurale

- Kodifikimi i garancive për heqjen dorë nga avokati – nëse sistemi shqiptar e lejon këtë mundësi, ndryshimi i KPP për të kërkuar që çdo heqje dorë nga e drejta për avokat të jetë e informuar, e qartë dhe vullnetare, e dokumentuar me shkrim (ose audio-video), pas shpjegimit të letrës së të drejtave në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, dhe e konfirmuar me nënshkrimin e të dyshuarit.
- Forcimi i rolit të avokatit gjatë marrjes në pyetje – parashikimi shprehimisht në KPP që avokatët mbrojtës mund të ndërhyjnë gjatë marrjes në pyetje për të mbrojtur privilegjin profesional, për të kundërshtuar pyetje të papërshtatshme dhe për të sqaruar keqkuptime, duke garantuar ndihmë juridike reale dhe jo thjesht formale.
- Garantimi i aksesit në kohë ndaj materialeve të çështjes – sigurimi që të dyshuarit dhe avokatët e tyre të kenë akses të menjëhershëm në dokumentet dhe provat thelbësore për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe thelbin e akuzave.
- Zbatimi i sistemeve të paanshme të avokatëve të gatshëm – krijimi i një sistemi 24/7 të menaxhuar nga dhoma e avokatisë, me kohë reagimi të shpejtë, për të parandaluar ndikimin e policisë në për zgjedhjen e avokatit dhe për të garantuar ndihmë juridike të menjëhershme dhe të pavarur.
- Përmirësimi i kushteve për asistencë efektive – detyrimi për të pasur ambiente për konsultime private në të gjitha komisariatet e policisë, për të mbrojtur konfidencialitetin mes avokatit dhe të dyshuarit.
- Detyrimi për regjistrim audio-video të marrjeve në pyetje – futja e regjistrimit të detyrueshëm të të gjitha marrjeve në pyetje, duke dokumentuar si praninë dhe pjesëmarrjen efektive të avokatit, ashtu edhe çdo heqje dorë nga të drejtat, për të garantuar drejtësi procedurale dhe besueshmëri të provave.

5. Alternativat ndaj paraburgimit

- Forcimi i përdorimit të alternativave ndaj paraburgimit – garantimi që gjyqtarët të vlerësojnë dhe zbatojnë sistematikisht masat më pak kufizuese përpara se të vendosin paraburgimin, në përputhje me parimin e paraburgimit si masë e fundit.
- Zgjerimi i regjimit të garancisë pasurore – rritja e fushës së zbatimit të garancisë përtej rrezikut të ikjes, duke e lejuar atë si alternativë edhe në rastet e rrezikut të përsëritjes së veprës apo pengimit të drejtësisë.
- Mundësimi i garancisë pasurore në fazën fillestare të ndalimit – ndryshimi i KPP për të siguruar që gjykatat të vlerësojnë mundësinë e garancisë përpara se të vendosin paraburgimin ose arrestin në shtëpi, në përputhje me nenin 5(3) të Konventës dhe Rregullat e Tokios të OKB-së.
- Krijimi i një sistemi efektiv dhe funksional të mbikëqyrjes elektronike, në përputhje me standardet e Rekomandimit CM/Rec(2014)4 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për mbikëqyrjen elektronike.
- Zbatimi i plotë i ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011, për mbikëqyrjen elektronike të personave me lëvizje të kufizuar me vendim gjykate, përmes sigurimit të mjeteve teknike të nevojshme dhe përshtatjes së nenit 237, paragrafi 2 të KPP.
- Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse – rritja e burimeve, trajnimit dhe autoritetit të organeve përgjegjëse për kontrollin e respektimit të masave alternative.
- Futja e urdhrat të ndalimit të kontaktit – ndryshimi i nenit 232 të KPP për të përfshirë “ndalimin e kontaktit me persona të caktuar”.
- Ndryshimi i nenit 57 të Kodit Penal, duke barazuar zbritjen nga dënimi përfundimtar me ditët e kaluara në paraburgim, dhe duke eliminuar bonusin aktual në fuqi.

6. Vëmendje e veçantë për personat në situatë vulnerabël

- Përcaktimi që paraburgimi i të miturve të përdoret vetëm si masë e fundit, për kohën më të shkurtër të mundshme dhe, kur është rreptësisht i nevojshëm, të miturit të mbahen të ndarë nga të rriturit.

- Sanksionimi i garancive procedurale për fëmijët – kufizimi i rasteve kur paraburgimi mund të zbatohet ndaj të miturve, asistencë e detyrueshme kur vendoset masa, përshtatshmëria e avokatit dhe shpjegime të përshtatura.
- Për gratë, lejimi që gratë shtatzëna të lindin në spitale jashtë ambienteve të paraburgimit dhe të mbajnë me vete fëmijët foshnje, gjithmonë kur kjo është në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës.
- Përcaktimi që shtetasit e huaj të kenë të drejtë informimi mbi ndihmën juridike dhe mbi mundësitë e transferimit të dënimit.
- Zbatimi i masave kundër radikalizimit – krijimi i një sistemi vlerësimi fillestar të rrezikut për të dyshuarit për terrorizëm/ekstremizëm, vlerësime të rregullta gjatë paraburgimit, trajnime për stafin për identifikimin e shenjave të radikalizimit, si dhe programe rehabilitimi dhe deradikalizimi.

7. Ankesat dhe mjetet juridike

- Rishikimi i kufizimeve dhe përjashtimeve – rishqyrtimi i përjashtimeve kufizuese, si mohimi i kompensimit kur vendimi i gabuar është “shkaktuar plotësisht ose pjesërisht” nga vetë personi.
- Rishikimi i ligjit të posaçëm mbi tavanet e kompensimit – përditësimi i ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005, për të garantuar që nivelet e kompensimit të jenë reale dhe proporcionale me dëmin e pësuar, duke reflektuar si dëmet pasurore ashtu edhe ato jopasurore.
- Përfshirja shprehimisht e arrestit në shtëpi në të njëjtin regjim kompensimi.
- Garantimi i zbatimit efektiv të vendimeve për kompensim – futja e garancive që sigurojnë pagesën e menjëhershme të kompensimit, me afate ligjore dhe mekanizma për të parandaluar vonesat administrative.
- Sigurimi i transparencës dhe aksesueshmërisë – ofrimi i rregullave të qarta procedurale dhe udhëzimeve të aksesueshme për aplikantët mbi mënyrën e paraqitjes së kërkesave për kompensim; ofrimi i ndihmës juridike për personat vulnerabël për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre.